

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI**

Nr. 3850/Prot.

Pogradec, më 21.10.2025

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

**Znj.MANJOLA KAMOLLI
KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK**

E nderuar zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po iu dërgojmë projekt vendimin dhe relacionin shoqërues, për:

PËR MIRATIMIN E FONDEVE PER INVESTIME TE NDRYSHME

Me respekt,

KRYETARI

Ilir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit:

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues:

Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin:



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI**

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më _____.2025

PROJEKT-VENDIM

NR. _____, DATË _____.2025

PËR MIRATIMIN E FONDEVE PER INVESTIME TE NDRYSHME

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar; Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, Udhezimit të Ministrise se Financave nr.2, date 06.02.2012, "Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit", i ndryshuar me nr 6 dt 16.05.2024 , Vendimin nr.140, datë 28.12.2024, "Për miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Pogradec për vitin 2025", Këshilli i Bashkisë:

VENDOSI:

1. Te miratoje fondet për investimet ne Buxhetin e Bashkise Pogradec si me poshte:

1. Permirësimi i kushteve të banesës të Z.Ylli Hysenbegasi në shumën 2,000,000 lekë
2. Rikonstrukcion i godines te ish Gjeologjisë në shumën 20,000,000 lekë
3. Rehabilitim i rrugës Rrëmenj – Gështenjas në shumën 24,000,000 lekë
4. Projekt zbatim per rehabilitimin e Qendrës kulturore "Lazgush Poradeci" në shumën 12,000,000 lekë
5. Projekt zbatim Rindërtimin e kompleksit shkollor "Koli Gusho" dhe "Muharrem dhe Esat Minarolli" në shumën 8,000,000 lekë.

2. Bashkia Pogradec merr angazhimin që fondet do të planifikohen për likuidim në Buxhetin e vitit 2026.

3. Për zbatimin e vendimit të ngarkohet Kryetari i Bashkise, Drejtoria e Ekonomise dhe Menaxhimit Financiar, pranë Bashkise Pogradec.

4. Vendimi të hyjë në fuqi 10 dite pas shpalljes.

KRYETAR

Manjola KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 3859 Prot.

Pogradec, më 21.10.2025

RELACION

PËR MIRATIMIN E FONDEVE PER INVESTIME TE NDRYSHME

Të nderuar Këshilltarë,

Projekt - Vendimi që po ju paraqesim vjen si rrjedhojë e domosdoshmërië për kryerjen e disa investimeve dhe projekteve të cilat janë shumë të rëndësishme për qytetin tonë.

Më poshtë po ju shpjegojmë rëndësinë e tyre dhe gjithashtu burimin e financimit.

Në mbështetje të ligjit nr 22/2018 „Për strehim social“, të ndryshuar dhe në zbatim të nenit 19, i cili parashikon përdorimin e fondeve të 3% të stehimit social për përmirësimin e kushteve të banimit të familjeve në nevojë, parqiten për shqyrtim dy raste prioritare që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme.

1. Përmirësimi i kushteve të banesës të Z.Ylli Hysenbegasi në shumën 2,000,000 lekë

Z.Ylli Hysenbegasi, pensionist i vetmuar, banues në njësinë administrative Buçimas Pogradec, ndodhet në kushte të vështira jetese kërkon përmirësim të kushteve të banesës për të garantuar një strehim të përshtatshëm.

2. Rikonstruktion i godines te ish Gjeologjisë në shumën 20,000,000 lekë

Godina e ish Gjeologjisë është në gjëndje të amortizuar dhe jashtë funksionit si godinë. Në të do të kryhen punime për të rregulluar objektin në tërësi si në çati dhe në ambientet e brëndshme të ndërtesës. Pas rikonstruktionit të kësaj godine, do të strehohen 6 familje në nevojë.

3. Rehabilitim i rrugës Rrëmenj – Gështenjas në shumën 24,000,000 lekë

Qellimi kryesor i këtij projekti është ndërtimi dhe sistemimi i një rruge me gjatësi 740 metra, e cila do të shërbejë si unazë lidhëse ndërmjet fshatrave Rëmenj dhe Gështenjas. Ky investim synon përmirësimin e ndjeshëm të infrastrukturës rrugore lokale, lehtësimin e qarkullimit të banorëve dhe mjeteve, si dhe krijimin e një lidhjeje më efikase me rrugët ekzistuese kryesore.

Rruga do të kontribuojë në zhvillimin ekonomik dhe social të zonës, duke mundësuar qasje më të mirë ndaj shërbimeve publike, shkollave, tregjeve dhe resurseve bujqësore, si edhe do të rrisë sigurinë dhe komoditetin e lëvizjes për komunitetin lokal.



Gjendja ekzistuese

Rruga paraqitet me shtresë të amortizuar, kryesisht me çakull dhe segmente të dëmtuara me gropa e deformime. Mungon sistemi i kanalizimit të ujërave të shiut, çka shkakton grumbullime dhe dëmtime të trupit rrugor gjatë periudhave me reshje. Në të dyja anët e rrugës ndodhen mure gurësh dhe sipërfaqe toke bujqësore, prandaj sistemimi do të bëhet duke respektuar kufijtë ekzistues dhe me kujdes për ruajtjen e aksesit të pronave anës rrugës.

Zgjidhja teknike e propozuar

Punimet parashikojnë sistemimin e plotë të rrugës, ndërtimin e shtresave rrugore dhe realizimin e një kanali kullues anësor të veshur me beton, për të garantuar largimin e ujërave të sipërfaqes.

Punimet që do të kryhen:

Pastrimi i trasesë ekzistuese

- Hiqen materialet e dobësuara, mbetjet, bimësia dhe shtresat e dëmtuara.
- Pastrohen anët e rrugës dhe hapen kanalet ekzistuese.

Gërmimi dhe profilizimi i trasesë

- Kryhet gërmim për arritjen e niveleve të projektit dhe sigurimin e pjerrësive të duhura për kullim.
- Gërmimi bëhet me thellësi sipas nevojës për të vendosur shtresat rrugore të parashikuara.

Vendosja e shtresave të bazës

- Shtresë çakulli (20 cm): vendoset, përhapet dhe ngjeshet me makineri vibruese.
- Shtresë stabilizanti (10 cm): vendoset sipër çakullit për të përforcuar strukturën mbajtëse dhe për të siguruar barazi në sipërfaqe.

Shtresat asfaltike

- Shtresa e parë – Binder asfaltik (trashësi 6 cm): përbëhet nga përzierje bituminoze me granulometri të përshtatshme për shtresa mbajtëse.
- Shtresa e dytë – Asfaltobeton (trashësi 4 cm): përbën shtresën përfundimtare të veshjes, duke siguruar sipërfaqe të lëmuar dhe rezistencë ndaj konsumit.

Ndërtimi i kanalit kullues anësor

- Në njërën anë të rrugës do të ndërtohet kanal anësor i veshur me beton, me gjerësi të sipërme rreth 40–50 cm dhe thellësi 40 cm.
- Kanali do të shërbejë për mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut, duke mbrojtur trupin e rrugës nga erozioni dhe dëmtimet.



Punime përfundimtare

- Pas përfundimit të asfaltimit, do të kryhen pastrimet përfundimtare të trasesë dhe hapësirave anësore.

3. Përfundime

Me realizimin e këtij projekti:

- Përmirësohet ndjeshëm qarkullimi i mjeteve dhe këmbësorëve,
- Sigurohet kullimi efektiv i ujërave të shiut,
- Rritet jetëgjatësia e rrugës dhe cilësia e jetës për banorët e zonës.
- Punimet do të kryhen në përputhje me standardet teknike shqiptare të ndërtimit të rrugëve

(STASH) dhe rregullat për mbrojtjen e mjedisit gjatë ekzekutimit të punimeve.

Fondet për këtë investim do të jenë të ndara ndërmjet Këshillit të Qarkut Korçë dhe bashkisë Pogradec. Në bazë të një marrëveshjeje që do të lidhet ndërmjet dy palëve do të bëhet e mundur që ky investim të mos rëndojë i gjithi në buxhetin e vitit 2026.

4. PROJEKTIMET

1. Projekt zbatim për rehabilitimin e Qendrës kulturore “Lazgush Poradeci” në shumën 12,000,000 lekë
2. Projekt zbatim Rindërtimin e kompleksit shkollor “Koli Gusho” dhe “Muharrem dhe Esat Minarolli” në shumën 8,000,000 lekë.

Ju Faleminderit,

Konceptoi: Irsa Karapanca

Besmira Niko

Paskalino Ziko

Miratoi: Dritan Babasuli


KRYETAR

ILIR XHAKOLLI

Detyra e Projektimit per Objektiv:Rehabilitimi dhe modernizimi i Qendres Kulturore "Lasgush Poradeci"

1. Gjendja egzistuese

Gjendja egzistuese e objektit paraqitet tejet e amortizuar si nga ana e shtresave rifiniturave, lageshtires qe eshte tejet prezente ne objekt dhe ka nevojë per nderhyrje te menjehereshme rehabilituese dhe modernizuese te objektit. Me poshte paraqiten planet dhe foto te gjendjes egzistuese:







FOTO TE GJENDJES EKZISTUESE



Institut Kombëtar i Monumenteve të Kulturës Komiteti Kombëtar i Monumenteve të Kulturës Komiteti Kombëtar i Monumenteve të Kulturës		
(Emri i Monumentit) PLANIMETRIA E KATIT TE DYTË, EKZISTUESE		
ARHITEKT	EMERGJENT (SHKURT)	Skala 1:200
INZHINIER	EDIS BLAZI	
ARHITEKT	EDIS BLAZI	







2. Kërkesa mbi kondicionet konstruktive dhe funksionale

Duhet të verifikohet plotësisht struktura e objektit. Të bëhen analiza të plota bashkëkohore për sigurinë e strukturës ekzistuese, modelime të plota të strukturave dhe mënyrën e ndërhyrjes në këto të fundit, bazuar në standartet europiane dhe kodet europiane EC dhe botërore të projektimit. Të meren në konsideratë gjithashtu Kodi shqiptar i Projektimit KTP 89.

Rrjetii ujësjellësit dhe i kanalizimeve

Gjatë hartimit të projekt-zbatimit duhet të merret në konsideratë perspektiva 10 vjeçare e rritjes së numrit të fëmijëve në këtë zone, rrjeti ekzistues i kanalizimeve të zonës ku do të ndërtohet apo rikonstruktohet objekti, por gjithashtu konsulenti duhet të marrë në konsideratë projektin e ri të kanalizimeve për këto zona. Gjithashtu duhet të merret në konsideratë, drejtimi i zhvillimit urbanistik i zonës do të merret në Bashki.

Rrjeti i shkarkimit të ujrave të zeza do të ndërtohet me materiale bashkëkohore dhe në përputhje me standartet në fuqi.

Sistemi elektrik i ndriçimit, i emergjencës dhe sigurisë

Konsulenti duhet të parashikojë ndriçimin e dhomave me ndriçues me fuqi të mjaftueshme për të garantuar një ndriçim në përputhje me normat në fuqi, dhe një numër të mjaftueshëm prizash për secilin ambient, sipas destinacionit të tyre.

Projektuesi duhet të sigurojë miratimin e projekteve elektrike në OSHEE, si dhe të përcaktojë edhe pikën e lidhjes me energji elektrike, nga rrjeti i fuqisë (kabina ose transformatori i zonës). Projektuesi duhet të parashikojë vendosjen e matësit elektrik trefazor, lidhjen e kontratës me Zonën e Shpërndarjes Elektrike, si dhe vlerën e përafërt të shtrimit të kabllit nga sahati deri te pika e lidhjes së miratuar, Projekti elektrik të jetë i shoqëruar me licencën e noteruar të inxhinierit elektrik, e cila do të shërbejë për procedurat e mëtejshme për miratimin e pikes së lidhjes me OSHEE.

Sistemi i mbrojtjes atmosferike

Godinat duhet patjetër të ketë sistemin e mbrojtjes atmosferike pasi Shqipëria gjëndet në një zonë me shkarkime atmosferike te shumta.

Sistemi i mbrojtjes atmosferike duhet të bëhet duke u bazuar në kushtet teknike të përcaktuara dhe në specifikimet e materialeve të ndërtimit.

Sistemi i mbrojtjes nga zjarri (MNZ)

Konsulenti duhet të paraqesë dhe projektin e mbrojtjes nga zjarri si dhe rregullat e sigurimit teknik për MNZ sipas normave dhe standarteve europiane.

Sistemi i lajmërimit për zjarrin

Në objekte të shikohet mundësia e një kabinë telefonike që të mund të përdoret në çdo moment. Numrat e telefonit të zjarrfikësit duhet të jenë të afishuar dukshëm në këtë kabinë. Ndërtesa duhet të ketë gjithashtu sistemin e brëndshëm të alarmit, nëpërmjet të cilit në rast rreziku të bëhet largimi nga ndërtesa. Sinjali i alarmit duhet të transmetohet në të gjitha ambientet e brëndshme

dhe të jetë i qartë e i kuptueshëm nga të gjithë. Sistemi i alarmit duhet të futet në punë pavarësisht nga furnizimi me energji elektrike i objektit.

Sinjalizuesit e tymit

Këto do të veprojnë në mënyrë që të mbajnë ekuilibrin ndërmjet dhomës së hapur dhe të mbyllur, kështu kur tymi depërton në dhomën e hapur ai do të ketë kontakt me qarkun dhe do të aktivizojë sinjalin. Të gjithë sinjalizuesit e tymit, të jenë instaluar të tilla që të mund të ndërrohen me zëvendësues.

Bombulat fikëse të zjarrit

Bombulat fikëse (me shkumë ose pluhur) duhet të vendosen në koridore dhe në ambientin teknik.

Kalimet e emergjencës, shkallët, koridoret

Numri dhe gjerësia e kalimeve të emergjencës duhet të sigurojnë largimin sa më të shpejtë dhe shfrytëzimi i tyre të nxjerrë në vend të sigurt jashtë ndërtesës me një rrugë të shkurtër, të shpejtë dhe pa rrezik.

Për përcaktimin e gjerësisë dhe gjatësisë së rrugëve të emergjencës, faktori kryesor është kohëzgjatja e largimit të personave nga objekti. Koha maksimale e largimit nga objekti në sekonda për çdo dhomë, mbas dhënies së sinjalit të alarmit duhet të jepet e llogaritur nga projektuesi.

Sistemi ngrohës dhe i ventilimit

Projektuesi duhet të parashikojë ndërtimin e plotë të sistemit ngrohës (ngrohje qendrore) duke argumentuar nga ana tekniko-ekonomike zgjedhjen e mënyrës së ngrohjes por njëkohësisht projekti të sigurojë ventilimin e ambienteve.

Efienca e Energjise

Projekti për auditimin e efiencaes se energjise, sipas VKM

3. Llogaritjet, specifikimet teknike dhe preventivi

Kosto totale do të përcaktohet nga preventivi përfundimtar i objektit, që do të përgatitet bazuar në projektin e zbatimit, specifikimeve teknike, relacionin, si dhe duke marrë parasysh dhe kërkesat e veçanta të Bashkisë në lidhje me standardet e pranuar.

Në hartimin e preventivit çmimet e referencës do të jenë sipas legjislacionit në fuqi,. Për zërat e punimeve që nuk gjenden në manual, projektuesi duhet të hartojë analiza përkatëse, të cilat do t'i bashkëlidhen të detajuara projekt zbatimit, kjo për të siguruar kursimin dhe efiençën e përdorimit të fondeve.

4. Fazat e realizimit të projektit

Projekti për objektet duke iu referuar VKM Nr. 354, datë 11.5.2016“Për Miratimin e manualit të tarifave për shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikëqyrje Dhe Kolaudim”, duhet të kalojë në këto faza

FAZA I Analiza e detyrës së projektimit

Analiza e detyrës së projektimit dhe termave të referencës do të përmbajë materialet e nevojshme grafike dhe vrojtuese të situatës, të paraqitura sipas termave të referencës specifike për secilin objekt.

FAZA II Projekt ide paraprake (Përgatitja e projektit dhe planifikimit)

Projekt ideja paraprake do të përmbajë pjesë të rëndësishme të zgjidhjes së detyrës së planifikimit në jo më pak se dy variante, përmbajtja e së cilave do të ketë analiza relacione, paraqitje grafike teknike, preventiv paraprak etj.

Varianti me treguesit më social - ekonomik dhe teknik, që do të përzgjidhet nga Autoriteti Kontraktor, do të vazhdojë procedurën e hartimit të projekt-idesë përfundimtare.

FAZA III Projekt ide përfundimtare (planifikimi i sistemit dhe i integritit)

Përpunimi i zgjidhjes përfundimtare të detyrës së planifikimit.

Në këtë fazë konsulenti do të përgatitë projekt – idene përfundimtare të nderhyrjeve, materiale e të cilës duhet të përmbajë Preventivat finale sipas legjislacionit në fuqi, analizat teknike të çmimeve, studimet dhe paraqitjet grafike të detajuara sipas zerave të punës.

FAZA IV: Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit: Përpunimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurat e nevojshme juridike e ligjore.

Projektuesi gjithashtu duhet të parashikojë dhe projektin për miratimin e lejes së ndërtimit, si i cili duhet të mbështetet në ligjin Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”. Është përgjegjësi e projektuesit aplikimi për leje ndërtimi nëpërmjet sistemit të aplikimit të lejeve on-line.

FAZA V: Projekti zbatimi: Përpunimi dhe paraqitja e planit të zgjidhjes së gatshme për zbatim

Mbas fazës së projekt idese përfundimtare konsulenti do të paraqes projekt zbatimit me të gjithë të dhënat e integruara e të miratuara të projektit, detaje, raporte preventive dhe të gjithë analizat përkatëse. Mbas kësaj faze projekti duhet të jetë i plotë për zbatim.

FAZA VI: Hartimi i preventivit përfundimtar

Për hartimin e preventivit projektuesi duhet të mbështetet në legjislacionin në fuqi.

Për secilin zë punimi, i cili nuk është i përfshirë në këtë manual, projektuesi duhet të dorëzojë analizat/ofertat përkatëse të çmimeve.

Në hartimin e preventivit, veç të tjerave do të mbahen parasysh sa më lart, lidhur me organizmin e zbatimit me fazë, çmimet e referencës sipas akteve ligjore në fuqi, dhe llogaritja e preventivit do të bëhet sipas normave dhe akteve ligjore në fuqi për të siguruar kursimin dhe efikasitetin e përdorimit të fondeve.

Të gjitha fletët e vizatimeve teknike duhet të jenë të detajuara me elementët përkatës, si dhe legjendat përkatëse.

Per te gjithë termat e mesiperme konsulenti duhet detyrimisht ti referohet normave te projektimit Shqiptare dhe te EU, apo praktikave me te mira bashkekohore per kategorite perkatese te objekteve.

Standarde në Projektim

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standardet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standardeve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e Projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standardeve dhe normave përkatëse. Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-se, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajnë elemente të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe limitimet për financimin e veprës. Në hartimin e projektit të mbahen parasysh të gjitha normat e miratuar për personat me aftësi të kufizuar, të verbrit, etj. Në projekt të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këtë kategori.

Detajet teknike të infrastrukturës për këtë kategori, të jepen nga Projektuesi në Fletë të veçanta të Projektit.

Standarde në paraqitjen e dokumentacionit teknik

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, më të avancuara të fushës.

Termat ePergjithshme te referencesper infrastrukturen rrugore

Gjatë hartimit të projekteve te infrastruktures rrugore, të mbahen parasysh *Studimet Urbanistike Pjesore*(nëse ka), parashikimet e *Planit të Ri Rregullues dhe Masterplani i Trasportit*. Gjithashtu, për të përcaktuar saktë kapacitetin për të gjitha shërbimet e kërkuara, duhet patur parasysh koeficienti i dendësisë së popullsisë, sipas *Rregullores së Urbanistikës* në fuqi ose 400 banorë/ha, si dhe duhen marrë në konsideratë zhvillimet urbane të pritshme dhe në perspektivë të zonës në fjalë.

1. Infrastruktura rrugore

Për trajtimin e rrjetit rrugor, gjerësisë së rrugës dhe trotuareve, duhet të mbahen parasysh standartet në fuqi (*Rregullorja e urbanistikës, KTP*).

Materialet, që do të përdoren, duhet te jenë sipas kushteve teknike të projektimit dhe ndërtimit të rrugëve.

Përveç saktësisë së të dhënave si më sipër, projektuesi, përpara se të fillojë punën me projektimin duhet, që paraprakisht:

Gjate hartimit te projekteve do te meret ne konsiderate duke bere analizat e nevojshme dhe propozimet e nevojshme teknike sipas rregulloreve ne fuqi te:

a) Skema e rrjetit rrugor

- b) Skema e qarkullimit/lëvizjes*
- c) Siguria dhe sinjalistika rrugore*

2. Ndriçimi rrugor

Per sa i perket ndricimit rrugor, duhet te respektohen normat Europiane te performancës së ndriçimit **EN 13201** :

Përzgjedhja e normës së ndriçimit sipas **PD CEN/TR 13201-1;2014**.

3. Kanalizimet e ujërave të zeza dhe ujërave të shiut

Per llogaritjen e sistemit te kanalizimeve te ujerave te zeza dhe te shiut, të merret në konsideratë perespektiva 20 vjeçare e rritjes së popullsisë.

Të merret në konsideratë ruajtja e rrjetit ekzistues që ka kapacitetin e mjaftueshëm përcejllës dhe është në gjendje të mirë punë. Informacion më i detajuar duhet të merret pranë Sh.a. Rajonale Ujësjellës-Kanalizime.

Drejtimi i zhvillimit urbanistik të zonës do të merret në Bashki.

4. Ujësjellësi

Në bashkëpunim me Ujësjellës-Kanalizime sh.a. do të saktësohet dhe gjendja e ujësjellësit ekzistues, projektet, që ka kjo ndërmarrje, si dhe problemet e vërejtura në këtë zonë gjatë periudhës së furnizimit me ujë me rrjetin ekzistues të ujësjellësit. Norma e furnizimit e rekomanduar do të jetë 150 l/ditë/banor.

5. Hidrantët zjarrfikës

Duhet të parashikohen hidrantet zjarrfikës, që të bëhet i mundur lehtësimi i punës gjatë veprimtarisë operationale për shuarjen e zjarreve, referuar normave të miratuara në fuqi dhe rregullores së PMNZSH-së.

6. Elementët urban

Projektuesi do të trajtojë në fazën e projekt zbatimit, përveç infrastrukturës në rrjetin rrugor edhe të gjitha hapësirat e lira urbane

7. Rrjeti Internet-Telefonisë

Të ndërtohet rrjeti i tubacioneve shpërndarëse të internet – telefonisë, sipas standarteve të përcaktuara duke marrë në konsideratë numrin e operatorëve operues në zonë, numrin e komunitetit përfitues, si dhe zhvillimin në prespektivë të këtij shërbimi, për një periudhë kohore 10 vjeçare. Ky rrjet duhet të shtrihet në të gjithë akset rrugore kryesore dhe sekondare si dhe të ketë ndërlidhje me rrjetin ekzistues në zonat kufizuese. (ajror ose nëntokësore).

Duhet të respektohet standarti i rregullores Nr. 22 AKEP, mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kablllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërrurbane të komunikimeve elektronike.

8. Standartet

a) Standarte në projektim

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektim, që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standarteve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standarteve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-së, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajnë elementë të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe limitimet për financimin e veprës.

Në hartimin e projektit të mbahen parasysh të gjitha normat e miratuar për PAK (personat me aftësi të kufizuar). Në projekt të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këtë kategori. Detajet teknike të infrastrukturës për këtë kategori, të jepen nga projektuesi në fletë të veçanta të projektit.

b) Standarte në paraqitjen e dokumentacionit teknik

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, me të avancuara të fushës. Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të parashikohet dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Ligji “Për urbanistikën”, Rregullorja e Urbanistikës dhe Legjislacioni në fuqi.

9. Realizimi i projektit

Realizimi i projektit te do të mbështetet në fazat e VKM Nr. 354, datë 11.05.2016, Neni 42, Neni 43 si mëposhte:

FAZA I Analiza e detyrës së projektimit

Analiza e detyrës së projektimit dhe termave të referencës do të përmbajë materialet e nevojshme grafike dhe vrojtuese të situatës, të paraqitura sipas termave të referencës specifike për secilin objekt.

FAZA II Projekt ide paraprake (Përgatitja e projektit dhe planifikimit).

Projekt ideja paraprake do të përmbajë pjesë të rëndësishme të zgjidhjeve të detyrës së planifikimit në jo më pak se dy variante, përmbajtja e të cilave do të ketë analiza relacione, paraqitje grafike teknike, preventiv paraprak etj.

Variante me treguesit më social - ekonomik dhe teknik, që do të përzgjidhet nga Këshilli Teknik, do të vazhdojë procedurën e hartimit të projekt-idesë përfundimtare.

FAZA III Projekt ide përfundimtare (planifikimi i sistemit dhe i integritetit)
Përpunimi i zgjidhjes përfundimtare të detyrës së planifikimit.

Në këtë fazë konsulenti do të përgatisë projekt – idene përfundimtare të nderhyrjeve, materiale e se ciles duhet të përmbajne Preventivat finale sipas legjislacionit në fuqi, analizat teknike të çmimeve, studimet dhe paraqitjet grafike të detajuara sipas zerave të punës.

FAZA IV: Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit: Përpunimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurat e nevojshme juridike e ligjore.

Projektuesi gjithashtu duhet të parashikojë dhe projektin për miratimin e lejes së ndërtimit, i cili duhet të mbështetet në ligjin Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”. Për këtë për çdo dokumentacion të nevojshëm për hartimin e projektit si dhe për aplikimin për leje ndërtimi përmes portalit, të bashkëpunohet me Drejtoritë përkatëse të Bashkisë Pogradec.

FAZA V:Projekti zbatimit: Përpunimi dhe paraqitja e planit të zgjidhjes së gatshme për zbatim.

Mbas fazes së projekt idese përfundimtare konsulenti do të paraqes projekt zbatimit me të gjithë të dhënat e integruara e të miratuara të projektit, detaje, raporte preventive dhe të gjithë analizat përkatëse. Mbas kësaj faze projekti duhet të jetë i plotë për zbatim.

FAZA VI: Hartimi i preventivit përfundimtar

Për hartimin e preventivit projektuesi duhet të mbështetet në legjislacionin në fuqi.

Për secilin zë punimi, i cili nuk është i përfshirë në këtë manual, projektuesi duhet të dorëzojë analizat/ofertat përkatëse të çmimeve.

Në hartimin e preventivit, veç të tjerave do të mbahen parasysh sa më lart, lidhur me organizmin e zbatimit me fazë, çmimet e referencës sipas akteve ligjore në fuqi, dhe llogaritja e preventivit do të bëhet sipas normave dhe akteve ligjore në fuqi për të siguruar kursimin dhe efikasitetin e përdorimit të fondeve.

Të gjitha fletët e vizatimeve teknike duhet të jenë të detajuara me elementët përkatës, si dhe legjendat përkatëse.

Për të gjithë termat e mesipërme konsulenti duhet detyrimisht të referohet normave të projektimit Shqiptarë dhe të EU, apo praktikave me të mira bashkëkohore për kategoritë përkatëse të objekteve.